

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **Kuvendi Komunal Vushtrri**

Për Aktivitetin e Prokurimit: **VU644-20-713-2-1-1**

Sa i përket tenderit për : **Hartimi I Projekteve**

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

TAULANT SHPK & STUDIO HAPSIRA SHPK
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

MAT- PRISHTINË
(Adresa)

PRISHTINË
(Vendi)

045-150-123
(Numri Telefonit)

10000
(Kodi postar)

/
(Numri i Faks-it)

DITIKA QATIPI
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

shpk.taulant2@gmail.com
(Adresa elektronike)

22.06.2020
(Data e parashtrimit të kërkesës)



(Nënshkrimi dhe vula)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

<u>N / A</u>	
(Emri i avokatit)	
<u>N / A</u>	
(Adresa e plotë)	
<u>N / A</u>	<u>N / A</u>
(Numri i Telefonit)	(Numri i faks-it)
<u>N / A</u>	
(Adresa elektronike)	
<u>N / A</u>	<u>N / A</u>
(Data e parashtrimit të kërkesës)	(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- Më datën 02.06.2020 jemi njoftuar mbi vendimin e eliminimit tonë
- Më datën 08.06.2020 kemi bërë kërkesë për ri-shqyrtim
- Më datën 10.06.2020 merr vendim mbi refuzimin e kërkesës për ri-shqyrtim.
-

Kriteri i dhënies Kontratës : Çmimi më i ultë.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☒

Jo ☐

Përmes platoformës elektronike , e-prokurimit .

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Përmes vendimit të datës : 10.06.2020 na është refuzuar kërkesa për ri-shqyrtim na është hudhurë poshtë.

VENDIM

1. Refuzohet si e pabazë Kërkesa për rishqyrtimin lidhur me Njoftimin Letër për Tenderuesin e eliminuar, të subjektit në procedurë: "Taulant "sh.p.k. & " Studio Hapësira "sh.p.k. me seli në Prishtinë, në procedurën e prokurimit me titull: " Hartimi i projekteve " Nr.i prokurimit: VU644 – 20 – 713 – 2-1-1 e Nr. i brendshëm: 644-20-008-211.
2. Vërtetohet si i bazuar Vendimi i Autoritetit Kontraktues – Drejtorisë Komunale për Prokurim Publik për vazhdimin e aktivitetit në bazë të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të dt. 01.06.2020

Arsyetim

Autoriteti Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik (në tekstin e mëtejme A.K.) në bazë të rezultatit nga procesi i ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve ka marrë vendim që ta rekomandoi për dhënie të kontratës Op. Ek.: N.T.SH. " Infratek " me seli në Lipjan ndërsa, O.E.: " Taulant "sh.p.k. & " Studio Hapësira "sh.p.k. me seli në Prishtinë (në tekstin e mëtejme Ankuesin) ta eliminoi si O.E. të papërgjegjshëm, bazuar në procedurën e zbatuar.

Njoftimi mbi Vendimin e A.K. si dhe Njoftimi letër për tenderuesin e eliminuar për Ankuesin janë dërguar për publikim në platformën elektronike më dt. 02.06.2020, bazuar në dispozitat e nenit 43 të Rregullores mbi Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik.

Në Kërkesën për rishqyrtim, Ankuesi konsideron se A.K. duke vendosur si në Vendimin e dt. 01.06.2020 ka shkelur dispozitat e LPP-së , konkretisht: nenin 7–Barazia dhe Trajtimi, nenin 51 – Njoftimi i kriterëve të dhënies së kontratës, nenin 56 – dispozitat e përgjithshme mbi përzgjedhjen e pjesëmarrësve dhe dhënien e kontratave, nenin 59 – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve dhe nenin 39 pika 39.8 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, më tej (ROUPP).

Autoriteti Kontraktues pasi i shqyrtoi një nga një pretendimet e Ankuesit të parashtruara në Kërkesë për Rishqyrtim dhe vlerësimit të provave në shkresat e lëndës, gjeti se Kërkesa e Ankuesit është e pabazë , për arsye se:

1. Procedura është zhvilluar bazuar në dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Neni 33 paragrafi 1 (Procedurë e Hapur) ka pasur për qëllim promovimin e transparencës, neni 60 paragrafi 1 pika 1.1 (tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët) ka pasur për qëllim që bazuar në të gjeturat dhe rezultatet nga procesi i ekzaminimit dhe vlerësimi të tenderëve të vendosë për dhënie të kontratës O.E. me tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët. Mbi këtë bazë A.K. vlerëson se Vendimi i A.K. i dt. 01.06.2020 është marrë bazuar në kushtet , rregullat dhe procedurën e përcaktuar ligjore të LPP-së, vendimi, sikurse ka

vlerësuar A.K., është i mbështetur mbi baza ligjore e faktike, i pandikuar, që nuk diskriminon dhe që ka një transparencë të lartë të vendimmarrjes dhe po ashtu duke zbatuar kërkesat procedurale dhe qenësore të dispozitave të LPP-së.

2. Autoriteti Kontraktues më tej vlerëson se të gjithë tenderët e tenderuesve në aktivitetin e prokurimit në fjalë janë trajtuar në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese ndërsa, i gjithë procesi ka qenë transparent, duke përfshirë këtu edhe të drejtën Ankuesit për të realizuar qasjen në dokumente të tenderit. Vendimi për ta rekomanduar për dhënie të kontratës Operatorin Ekonomik: N.T.SH. " Infratek " me seli në Lipjan " është marrë në mes tjerash edhe në zbatimin e nenit 59 të LPP-së, sepse një tender do të konsiderohet i përgjegjshëm dhe i pranueshëm vetëm nëse përmbushë kërkesat administrative, profesionale dhe minimalisht ato teknike dhe / ose profesionale të saktësuar në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë.

3. Sa i përket pretendimit të Ankuesit se A.K. ka shkelur nenin 56 të LPP-së lidhur me dispozitat e përgjithshme mbi përzgjedhjen e tenderuesve, A.K. konstaton padiskutueshëm se dispozitat e nenit 56 janë respektuar në plotni pasi që A.K. ka vlerësuar dhe vendosur vetëm mbi bazën e kërkesave dhe / ose kritereve që janë cekur në Njoftimin e Kontratës dhe në Dosjen e Tenderit. Sikurse është saktësuar në Njoftimin për Kontratë, nenin III.2 – Kushtet për pjesëmarrje pika III.2.1. – Kërkesat e përshtatshmërisë lidhur me Seksionin II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT) të Dosjes së Tenderit, nenin 6.4 – Pranueshmëria e O.E., O.E. ka qenë i obliguar të siguroi saktësinë e tenderit të tij si dhe të siguroi dorëzimin e rregullt të dëshmimeve të kërkuara, mes tjerash edhe atyre lidhur me pranueshmërinë, si kusht Administrativ. Nga procesi i vlerësimit dhe ekzaminimit të tenderit të Ankuesit, A.K. ka konstatuar se anëtar i Grupit të O.E. "Taulant" sh.p.k. Deklaratën nën Betim e ka plotësuar në mënyrë jo të rregullt nga se në preambulë të Deklaratës në Betim, referenca është për O.E. "Studio Hapësira" sh.p.k., ndërsa të dhënat më tej për O.E. "Taulant" sh.p.k. Kjo e bënë Deklaratën nën Betim të O.E., fictive, jo të rregullt dhe jo valide, për rrjedhojë dhe të pa pranueshme për A.K. Më tej, A.K., ka konstatuar se kjo parregullsi paraqet largim dhe kufizim substancial nga Kërkesat Administrative të saktësuar në Dosjen e Tenderit sepse dallon esencialisht nga kushtet e Dosjes së Tenderit sepse dokumenti është i plotësuar në mënyrë të parregullt dhe po ashtu kufizon të drejtat e A.K. në këtë procedurë sepse dokumenti i dorëzuar, në çfarëdo rasti, nuk mundë të përdoret si dokument valid, andaj dhe pranimi i një dokumenti të tillë me gabime të konsiderueshme do të mundë të trajtohet edhe si trajtim i pa barabartë i tenderuesve.
4. Pretendimi i Ankuesit se devijimi në Deklaratën nën Betim paraqet vetëm gabim të vogël teknik, që nuk ka ndikim material dhe që nuk i ndryshon kushtet e dosjes së tenderit, sipas A.K. është i pasaktë dhe në kundërshtim me dispozitat e LPP-së, sepse në rastin konkret nuk bëhet fjalë për paqartësi të dokumentit të dorëzuar por për dokument të plotësuar në mënyrë të parregullt, korrigjimet e të cilit nuk janë paraparë me dispozitat e LPP-së.
5. Mbi këto konstatime të A.K. sikurse u sqarua më lartë në këtë Vendim, bazuar dhe në dispozitat e nenit 59 pika 4 të LPP-së se, citat : " Autoriteti Kontraktues do të konsideroi një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në Njoftimin e Kontratës dhe në Dosjen e Tenderit dhe nenin 41.4 të RRUOPP se citat : " Tenderi konsiderohet të jetë i përgjegjshëm kur është në pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të Dosjes së Tenderit", A.K. ka vendosur që Kërkesa për Rishqyrtim e Ankuesit të refuzohet si e pa bazuar.
6. Në fund A.K. më tej vlerëson se me rastin e marrjes së vendimit për të përzgjedhur për rekomandim me dhënie të kontratës të O.E.: N.T.SH. " Infratek " nuk ka elemente apo prova se janë shkelur dispozitat e cituara si më lartë në këtë Vendim, konkretisht neni 7 – Barazia në trajtim/ Jo - diskriminimi sepse është rekomanduar O.E. me tender të përgjegjshëm dhe me çmimin më të ulët ndërsa me asnjë provë nuk është vërtetuar se ndonjë O.E. është trajtuar Jo-barabar apo diskriminuese, nuk është vërtetuar se nuk ka pasur transparencë apo konkurrencë në mes O.E., neni 51 – Njoftimi i kritereve të dhënies së kontratës dhe neni 59 parag.4 – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve, andaj edhe pretendimet e Ankuesit lidhur me këto çështje, sikurse ka konstatuar dhe sqaruar A.K., janë të pabaza, jo të sakta dhe si të tilla janë hedhur poshtë.

Nga sa u tha me lartë, e në përputhje me nenin 108/A pika 10 paragrafi 10.1 të LPP-së A.K. vlerëson se nuk ka asnjë arsye të vendosë ndryshme nga ajo që është thënë si më lartë, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Autoriteti Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik
K.R. nr. 008/2020 - datë 10/06/2020

Vendimi i dërgohet:

Drejtoria për Prokurim Publik

1. 1x Palës
2. 1x DKP
3. 1x Arkivë (1 kopje)


Hyda Dallku-ZPP

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

NENI 7 : Barazia në trajtim / jo-diskriminimi.

NENI 51 : Njoftimi i kriterëve të dhënies kontratës.

NENI 56 : Dizpozita e përgjithshme mbi përzgjedhjen e pjesëmarrësve dhe dhënien e kontratave .

NENI 59 : Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve.

RRUOPP (Rregullat dhe Udhëzuesi Operativë i Prokurimit Publikë) , neni 39 dhe 39.8

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshtatjet rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

PRETENDIMI ANKIMORË :

Prentendimi Ankimorë I AK – Deklarata në Betim nga Anatar GOE Taulant SHPK është e plotësuar por jo në mënyrë të rregullt , duke konsideruar jo Valide

Këtë pretendim të AK e konsiderojmë të pa qëndrueshëm duke u bazuar në këtë :

ARGUMENT

Konform NENI 6.4 të Dosjes Tenderit kemi dorëzuar dëshmitë e dokumentuara në FDT konform këkesave të përshtatshmërisë profesionale NENI 9.1&9.2 të dosjes tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Pretendimi I AK se në pajtimin e dispozitave ligjore NENI 59 I LPP dhe NENI 39 pika 39.8 është Refuzuar Tenderi është **I PA QËNDRUSHËM.**

ARSYETIM :

1. Deklarata në BETIM I njërit nga GOE Taulant SHPK është e plotësura , është kontaktuar që identifikimi I OE , I vulosur dhe I nënshkruar nga vetë Oepratori Ekonomik Taulant SHPK përveq një gabimi tesktual nuk mund të konsiderohet jo valid , duke marrë parasysh që Deklarata në Betim është pjesë e dosjes , dhe dosja është vulosur dhe nënshkruar nga vet OE Taulant SHPK , mban identifikimin e vetë OE Taulant SHPK dhe I plotësuar dhe vulosur nga AI si : LIDER I GRUPIT.

Vërejtje : Në preanullën e Deklaratës në betim - Fillon teksti **UNË I POSHTË SHËNUARI** – Që I referohet Identifikimit të Operatorit Ekonomik , duke marrë parasysh që identifikimi i OE është plotësuar dhe vulosur në mënyrë të rregullt nuk mund të shpallet deklarata në betim dhe nuk mund të konsiderohet si kufizimi dhe largim substancial nga kërkesat Administrative të FDT – Pasi kusht Administrativ është plotësimi në mënyrë të rregullt të rubrikave të zbrazuar tek Identifikimi I Operatorit Ekonomik I nënshkruar dhe vulosur.

Neni 59

Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmeja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundur, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

Neni 59 , paragrafi 4 – Shumë qartë I precizon që gabimet teknike , dhe devijimet e vogla gjatë plotësimit të dosjes tenderit lejohen dhe mund të korrigjohen , e cila nuk ka ndikim dhe nuk e ndryshohen kushtin material gjatë procedurave të prokurimit.

NË RASTIN TONË – Devijim I vogël nuk ka asnjë ndikim material , dhe nuk I ndryshon kushtet, e dosjes tenderit dhe konkurrencës gjatë zhvillimit të procedurave të Prokurimit public.

(Kjo më shumë ka të bëjmë me deklarinë lidhur ofrimin e dokumenteve të rrejtshme apo mashtruese)

1. Përveq Deklaratës në Betim në dosjen e tenderit , OE Taulant konform NENI 26.8 të URROP ((Rregullat dhe Udhëzuesi Operativë i Prokurimit Publikë), kemi ofruar si dokumentë plotësues i cili qartë precizon nëse Taulant SHPK merr përgjegjësin ,penale jurike nëse kompani ofron informata të rrejtshme apo mashtruese , edhe kjo deklarata është deklarata plotësuese e Deklaratës në Betim e nxjerr nga FDT.
2. Pretendimi I AK të mbështetur në NENIN 39 pika 39.8 (URROP) është I pa qëndrueshëm.

Pasi askund në këtë NEN nuk precizohet nëse deklarata në Betim nuk është plotësuar në rregull –Mund të konsiderohet deklarata Betim JO VALIDE

39.8 AK duhet të dërgojë "Kërkesë për sqarim të tenderit" OE përmes sistemit të prokurimit elektronik, dhe OE duhet të dorëzojë përgjigjen e tyre tek AK në një dokument të shkruar me anë të sistemit elektronik. Nënshkrimi digjital nuk është i obligueshem deri ne njoftim zyrtar nga KRPP.

Mungon deklarata e qartë ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës	Mund të kërkohen informata sqaruese	Kusht administrativ
--	-------------------------------------	---------------------

Ne kemi dorëzuar Deklaratë në Betim në kuadër të Antarve të Grupit Operatorëve , dhe nëse njëra prej deklarave nuk është e qartë mund të kërkohen informatat, edhe pse është kusht Administrativ –AK nuk mund të jo-validitojë por të kërkojë informatat.

NJË VEPRIM TË TILLË NUK E KA BËRË AUTORITETI KONTRAKTUES

3. RAST- PRAKTIK E GJYKUAR NGA OSHP – Vendimi NR 221/18 I datës 27.06.2018 , Autoriteti Kontraktues Kuvendi Komunal Suharek.

Paneli shqyrtues I OSHP- Gabimi teknik të deklaratës betim e ka konsideruar si dokument të dosjes tenderit , dhe ka konsideruar që edhe faqet tjera janë të plotësuar nga OE dhe konsideron si Valid Deklaratën në Betim

Paneli shqyrtues lidhur me pretendimin e OE ankues, se AK KK-Suharekë ka bërë shkelje të nenit 6,7, 56, 59, 60, 69 dhe nenin 72 të LPP-së, kur rekomandon për kontratë OE i cili ka dorëzuar Deklaratën nën Betim me datë të pasakte, që nuk konsiston me periudhën e procedurës së aktivitetit të prokurimit, çfarë e bënë këtë deklaratë të pavlefshme, konstaton se ky pretendim i operatorit ekonomik ankues nuk është i bazuar sepse OE rekomanduar për kontratë për LOT 3 "STUDIO HAPESIRA" sh.p.k. ka paraqitur Deklaratën nën Betim që mban datën 230.03.2018 mirëpo përshkrimi i datës "230" nuk mund ta bëjë një deklaratë nën betim të pavlefshme sepse shihet qartë se është gabim teknik, po ashtu AK me njoftim për kontratë dhe dosje të tenderit ka parashtruar se OE duhet të përmbushin kërkesën "Deklarata nën betim, që tenderuesi i plotëson kërkesat mbi përshtatshmërinë në pajtim me Ligjin Nr.04L-042" si dhe ka kërkuar dëshmi "Deklarata nën betim e nënshkruar dhe e vulosur (ky dokument është pjesë e dosjes)" andaj konstatohet se gjitha faqet tjera të dosjes së tenderit të dorëzuara nga OE "STUDIO HAPESIRA" sh.p.k. përmbajnë datën 20.03.2018.


Paneli shqyrtues me rastin e vendosjes në këtë aktivitet të prokurimit mori parasysh nenin 6 të LPP-së, sepse oferta e operatorit ekonomik OE "STUDIO HAPESIRA" sh.p.k. e shpallur fitues për LOT 3 nga AK përmban çmim në vlerë prej 2,460.00€, e që është dukshëm më e lirë se oferta e OE ankuese për LOT 3 e cila përmban çmim në vlerë prej 4,180.15 €, OE ankuese ka ofertë më shtrenjtë se sa OE i rekomanduar për dhënie të kontratës në vlerë prej 1720,15 €.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
Nuhi PACARIZI



Bazuar në vendimin e OSHP –së gabimet teknik, nuk mund ta bëjë deklaratën betim të pa vleshme, pasi deklarata në betim pjesë e dosjes së tenderit, nëse dosja e tenderit është plotësuar nënshkruar dhe vulosur në mënyrë të rregullt dhe e ngarkuar në sistemin e prokurimit public e-prokurimi.

5 RAST- PRAKTIK E GJYKUAR NGA OSHP – Vendimi NR 230,232,235/18 I datës 15.06.2020 , Autoriteti Kontraktues Ministria e infrastukturës , Titulli Kontratës: Hartimi I projekteve dhe konsulencë teknike.

trajtoj tenderin njëjtë me tenderët tjerë; ose 4.6.2 Nëse sqarimi nuk mjafton, të refuzoj tenderin dhe, në përputhje me nenin 61 të LPP-së të njoftoj KRPP, duke përdorur formën standarde të miratuar nga KRPP, "Njoftim për refuzim të tenderit abnormalisht të ulët", brenda dy dite nga data e vendimit. Gjithashtu, duke u bazuar në nenin 61 paragraf 3: Pas marrjes parasysh të informacioneve dhe shpjegimeve që janë dorëzuar nga tenderuesi sipas paragrafit 1. të këtij neni, nëse autoriteti kontraktues konstaton se tenderuesi ka dorëzuar një shpjegim të mjaftueshëm të bazave të tenderit të tij, autoriteti kontraktues duhet të trajtojë tenderin e tillë në mënyrën e njëjtë siç i trajton edhe tenderët e tjerë.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues NNSH "VIZION PROJECT" – Prishtinë.

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Eksperti shqyrtues konstaton se Operatori ekonomik ankues NNSH "VIZION PROJECT", pretendon se OE i rekomanduar për kontratë "FIDAN HASANAJ B.I & LORENCO CO SHPK & GES PLAN SHPK", është i pa përgjegjshëm sepse tek dokumentet e dorëzuara dy nga anëtarët e këtij konsorciumi të shpallur fitues Deklaratën nën Betim e kanë me dt:15.01.2019, pra shumë më herët se sa data kur është bërë Njoftimi për kontratë për këtë aktivitet të prokurimit. Nëse shikojm Deklaratën nën Betim shihet qartë se data e vendosur është 15.01.2019, ndërsa tenderi është shpallur me dt:30.12.2019, dhe dorëzimi i tenderit ka qenë me dt:29.01.2020, pothuajse një vit përpara hapjes së këtij aktiviteti të prokurimit.

Eksperti shqyrtues sqaron se Deklaratat nën Betim të anëtarëve të konsorciumit "FIDAN HASANAJ B.I & LORENCO CO SHPK", janë të dt:15.01.2019, ndërsa Deklarata nën Betim e anëtarit të konsorciumit "GES PLAN SHPK", e ka dt:15.01.2020, andaj duke pasur parasysh që të tri (3) Deklaratat nën Betim, janë 15.01, mirëpo ju ndryshon viti, kjo më tepër mendoj se është një gabim teknik, dhe si i tillë ky pretendim nuk ka ndonjë relevancë.

Përgjigje në Pretendimi nr.2

Eksperti shqyrtues konstaton se OE ankues NNSH "VIZION PROJECT", pretendon se OE i rekomanduar për kontratë "FIDAN HASANAJ B.I & LORENCO CO SHPK & GES PLAN SHPK", në listën e stafit ka prezantuar Menaxher të projektit z. Qamil Kdiri me profesion Inxhinier i Diplomuar i Gjeodezisë, i cili inxhinier në kontratën e tij me kompaninë Fidan Hasanaj B.I, liderin e konsorciumit nuk shihet askund që është e shënuar as titulli dhe as numri i prokurimit, ashtu siç ka kërkuar AK-ja në kërkesën tek DT dhe tek njoftimi

Bazuar në vendimin e OSHP –së gabimet teknik , nuk mund ta bëjë deklaratën betim të pa vleshme , dhe ka potencuar që nuk ka ndonjë relevance në aktivitetin të këtij aktiviteti prokurimit.

Numri i prokurimit: VU644-20-713-2-1-1 apo nr. i brendshem: VU644-20-008-211 Titulli: Hartimi i projekteve

Aneksi 2. DEKLARATA NËN BETIM

Unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar **TAULANT SHPK** deklaroj nën betim se jam i përshtatshëm në përputhje me Nenin 65, të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Bazuar në Neni 26.8 i Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik (RROUPP) përcakton se : Në rastet kur lëshimi i dokumenteve ose Certifikatave, nën Kërkesat e Përshtatshmërisë ose Përshtatjet Profesionale, nuk janë të arritshme për arsye objektive, ose kur këto dokumente nuk mbulojnë të gjitha rastet për të cilat evidenca duhet të prodhohet, një Deklaratë e shkruar në Betim nga OE mundë të pranohet si evidencë e mjaftueshme. Në kuptim të kësaj si dhe në përputhje me rrethanat e krijuara duke marrë në konsideratë distancimet dhe / ose kufizimet sociale si masë mbrojtëse kundër pandemisë së Corona-Virusit COVIT-19, dhe meqenëse në këto rrethana edhe institucionet komunale e kanë kufizuar punën me palë dhe nëse është e pamundur të nxjerrët Vërtetimi nga komuna Juaj (dëshmi e kërkuar nga A.K. në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë në bazë të nenit 65 të LPP-së) Ju, si Operatorë Ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës, si evidencë të mjaftueshme duhet të dërgoni tek Autoriteti Kontraktues një Deklaratë me shkrim nën Betim të vulosur dhe nënshkruar nga personi i autorizuar i O.E., duke i potencuar arsyet objektive për pamundësinë e sjelljes së dëshmisë së tillë.

Përmes kësaj deklarate në Betim deklaroj për shkak të Pandemisë COVIT-19, duke marrë parasysh unë Znj. Ditika Qatipi e kemi të pamundur të vijmë (Lëvizim) në Kosovë për ta hapur dhe dorëzuar te ju, Identifikimit Financiar original nga Banka me seli në Kosovë, për shkak të Kufijve të cilët janë të bllokuar nga pala Qeverisë Shqiptare po ashtu edhe nga pala e Qeverisë Kosovare.

Unë vërtetoj përmes kësaj Deklarate në Betim në moment që më ipet mundësia me tejkalimin e gjendjes pandemisë COVIT-19 do ta sjelli Identifikimit Financiar Original nga njëra nga bankat me veprimtari në Kosovë.

Përmes kësaj kërkesë i adresohemi Autoriteti Kontraktues (Komuna Vushtrisë), që dokumentin e dorëzuar (Deklarata në Betim), ta trajtoj si evidencë të mjaftueshme për dhënie të Kontratës, deri në tejkalim të situatës së pandemisë COVIT-19

Unë pranoj mundësinë e sanksionimeve penale dhe civile, gjobave dhe dënimeve, nëse unë për shkak të pakujdesisë dorëzoj çfarëdo dokumenti ose deklarata që përmban informata përmbajtësish të gabueshme ose mashtruese apo dështoj ta dorëzoj dokumentit e kërkuar konform kërkesave të përshtatshmërisë profesionale të dosjes tenderit pa tejkalimit të pandemisë COVIT-19.

dhe Udhëzuesi Operativë i Prokurimit Publikë), Shifet qartë Identifikimi E OE ,Numrin e Prokurimit (Të BREDSHËM DHE TË JASHTËM) të Aktivitet Prokurimit të Kuvendit Komunal Vushtrri si dhe Titullin e Kontratës : HARTIMI I PROJEKTEVE

Numri i prokurimit: VU644-20-713-2-1-1 apo nr. i brendshem: VU644-20-008-211 Titulli: Hartimi i projekteve

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i OE:	TAULANT SHPK
Adresa e plotë:	RR. GJIK KULAQI- TIRANË
I përfaqësuar nga:	
Emri	DITIKA QATIP
Pozita	DREJTORESH
Nënshkrimi	
Data	12.05.2020
Vula	



Deklaratës në Betim në dosjen e tenderit , OE Taulant konform NENI 26.8 të URROP ((Rregullat dhe Udhëzuesi Operativë i Prokurimit Publikë), Shifet qartë Identifikimi E OE ,Numrin e Prokurimit (Të BREDSHËM DHE TË JASHTËM) të Aktivitet Prokurimit të Kuvendit Komunal Vushtrri si dhe Titullin e Kontratës : HARTIMI I PROJEKTEVE

PËRFUNDIM :

Duke u bazuar në argumentet e specifikuar më lartë kërkojmë nga AK të bëjë anulimin e VENDIMIT PËR DHËNIE TË KONTRATËS , e njëjta ta kthejë lëndën në rivlerësim dhe të marrë si të bazuar ankesën tonë , pasi konsiderojmë që AK gjatë këtij aktiviteti të prokurimit në masë substanciale nuk e ka rrespektuar LPP

Në të kundërtën kundër këtij vendimi jemi të obliguar të bëjmë ankesë në OSHP ,

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Shkeljet e supozuara kanë shkaktuar dëmtim të imazhit kompanisë , një numër i konsiderueshëm të punëtorve kanë mbetur pa punë , duke llogaritet shpenzimet , kamatatë ,tarifën e avokatit deri sa të zgjidhen kontekstet.

Vlera e dëmit kap vlerën 200,000.00€, të cilën Autoriteti Kontraktues është i obliguar të ja paguaj palës dëmtuar në rast se humb kontekstin Gjyqësorë

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*